



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:197414

Datë: 15.11.2023

Numri i dokumentit: 04922713

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.634/21

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me procesmbajtëse Shpresa Kërnje në çështjen penale kundër të pandehurit A. N. nga Peja, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1550/21 të datës 03.09.2021 për shkak të veprës penale Vetëgjyqësia nga neni 410 par.1 të KPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 14.11.2023 në prezencë të prokurorit së shtetit Dorjan Juniku te pandehurit A. N. dhe te dëmtuarit A. D., me datë 15.11.2023 shpalli dhe përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

A. N., i biri R. dhe nënës V., e gjinisë L., i lindur me dt., në fsh. N. K- Pejës, ku edhe banon rr “M. M. “pa nr , ka të kryer shkollën e mesme , me lnj.nr....., me profesion bujk, i martuar ,baba i tre fëmijëve , i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. se Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Me datë 06.08.2021 rreth orë 08:00, në fshatin R. K. Pejë, ushtron në mënyrë arbitrare të drejtën që mendon se i takon në vend se t’i drejtohet organit kompetent, në mënyrën që, pasi i dëmtuari H. D.fillon ndërtimin e shtëpisë në parcelën nr. P-..... ZK R. K. Pejë, i pandehuri me pretendimin se shtëpia është duke u ndërtuar në pronën e tij, shkon në vendin e lartcekur dhe dëbon punëtorët nga shtëpia e të dëmtuarit duke penguar ndërtimin.

- me këtë ka kryer veprë penale të Vetëgjyqësia nga neni 410 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

Të pandehurit A. N. i shqipton :

- I. DENIM ME GJOBË ne lartësi prej 300 (treqind) euro, të cilin detyrohet ta paguaj në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast që i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.
- II. Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.
- III. Kërkesë pasurore juridike nuk pati nga i dëmtuari.

ARSYETIM

A. Historiku i çështjes dhe vendimi në lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 03.09.2021 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1550/21 kundër të pandehurit A. N. për shkak të veprës penale Vetëgjyqësia nga neni 410 par.1 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 14.11.2023 e mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor në të cilën prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku i pandehuri A. N. dhe i dëmtuari A. D., në të cilën seancë i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe në kuptim të nenit 322 lidhur me nenin 242 par.2, 3 dhe 6 të KPPRK-së gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Ne fjalën përfundimtare prokurori i shtetit deklaroi “Pasi gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor kryesor i akuzuari A.N., e pranoj fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, duke theksuar se është e vërtetë se ditën kritike në kohën e përshkruar si në aktakuzë, i ka larguar në mënyrë arbitrare punëtorët të cilët i kishte angazhuar i dëmtuari A. D., për punët që kishin të bënin me ndërtimin e shtëpisë, me ç’rat me këto veprime i njëjti është inkriminuar në figurën e veprës penale për të cilën pandehet, e kjo për faktin se edhe pse i njëjti kishte mundësi që në Gjykatën Themelore në Pejë – Departamenti Civil. Të parashtronte padinë dhe të kërkonte shqiptimin e masës së përkohshme, ndalimin punimeve ndaj këtu të dëmtuarit A.D., i njëjti nuk e kishte ndërmarr një veprim të tillë duke vepruar në vetëgjyqësi.

Andaj nga sa u tha më lartë mbës në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të saj, ashtu që nga Gjykata kërkoj që të akuzuarin ta shpall fajtor, ta dënoj sipas Ligjit, si dhe ta obligoj në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa në rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese”.

I dëmtuari deklaroi “Na me të akuzuarin jemi kojsi me shpija, plus jeni tezakë në mes vete, kurgjo të keqe nuk kemi pas kurrë në jetë, kam tentuar me u marr vesh për atë pronë, nuk kemi arrite me u marr vesh, përpos këtij rasti në aktakuzë ka qenë edhe një dit tjetër që i ka përzonë punëtorët, s’kam mujt me u marr vesh me A. dhe e kam thirr vëllain e tij më të madh ai e ka marr për sipër me e pru kadastrën, pas kadastrës e kam ndërtua edhe zidin mes parcelave që është ekzistues, unë nuk kam kurgjo të keqe me A. dhe jam i gatshëm që kjo çështje të zgjidhet edhe me gjykatë nëse është nevoja edhe shtëpinë prishi”.

Në fjalën përfundimtare i pandehuri A. N. deklaroi “ Unë veç kam me thonë se ajo pronë oshte e jemja dhe jam i gatshëm që edhe me kadastër dhe gjykatë me vërtetu një gjë të tillë”.

B. Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe renduese të çështjes.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurit vendosi që të shqiptoj dënim me gjobë prej 300 (treqind) euro, të cilin detyrohet ta paguaj në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast që i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin nuk kemi rrethana renduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar dhe keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri me rastin e pranimit të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Dënimin më gjobë gjykata e shqiptoj duke u bazuar në faktin se për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri ligjvënësi ka paraparë shqiptimin e dënimit me gjobë ose me burgim në mënyrë alternative, andaj gjykata duke u bazuar në nenin 43 par.1 dhe 2 të KPRK-së vendosi që të pandehurit t'i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, më bindjen se ky dënim, do të arrijnë në mënyrë të mjaftueshme të shprehin gjykimin shoqëror për veprën e kryer.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit A. N. është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 450 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjorë nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.634/21, me datë 15.11.2023

Procesmbajtësja:
Shpresa Kërnje

Gjyqtari i vetëm gjykues:
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.